



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

## GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:217781  
Datë: 30.04.2024  
Numri i dokumentit: 05640798

CAP.nr.919/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren individuale Hidajete Gashi Alaj, në çështjen përmbartimore të kreditorit F.F nga Prishtina të cilin e përfaqëson me autorizim F.M, avokat në Prishtinë kundër debitorit SHSKUK-QKUK në Prishtinë, objekt i përmbartimit kërkesa në të holla, duke vendosur sipas ankesës së kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Cpc.nr.1130/21, i datës 27.03.2023, jashtë seance me datë 30.04.2024 mori këtë:

### A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e kreditorit F.F nga Prishtina, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, Cpc.nr.1130/21, i datës 27.03.2023 ANULOHET dhe lënda i kthehet të njëjtës në procedim të serishëm.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e atakuar Cpc.nr.1130/21, i datës 27.03.2023, ka vendosur si në vijim:

*“REFUZOHET propozimi për lejimin e përmbartimit të kreditorit F.F nga Prishtina, i ushtruar në këtë gjKatë me datë 22.09.2021, si i pa bazuar.”*

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale andaj i ka propozuar Gjykatës së Apelit, që të aprovohet ankesa e kreditorit, t'a shfuqizoj aktvendimin e shkallës së parë dhe ta kthej çështjen në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur i autorizuari i debitorit.

Gjyqtarja individuale e Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori F.F, përmes të autorizuarit të tij, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit SHSKUK, në bazë të dokumentit përmbartues – Vendimit nr. 01 Nr.1432/337, i datës 23.03.2020 të Inspektoratit të Punës në Prishtinë, për shumën e borxhit prej 377.00 euro. Si dhe shpenzimet procedurale i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin, Cpc.nr.1130/21, i datës 27.03.2023 e ka refuzuar propozimin për lejimin e përmbartimit.

Në arsyetim të aktvendimit Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas shqyrtimit të propozimit për përmbartim dhe analizimit të shkresave të lëndës ka gjetur se propozimi për lejimin e përmbartimit duhet të refuzohet si i pa bazuar, e kjo për shkak se dokumenti në bazë të të cilit është propozuar që të iniciohet procedura, i njëjti nuk është i përshtatshëm për përmbartim pasi që ka konstatuar se dokumenti përmbartues nuk përmban klauzolën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë ashtu siç përcaktohet me nenin 36 të LPP-së.

Gjykata ankimore gjatë vlerësimit të pretendimeve ankimore, gjen se pretendimet e kreditore qëndrojnë pasi që aktvendimi me të cilin është refuzuar propozimi për përmbartim është marrë në shkelje të dispozitave të procedurës përmbartimore për çka i njëjti detyrimisht është dashur të priset dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Gjykata e Apelit nuk e pranon përfundimin e Gjykatës së shkallës së parë se propozimi për përmbartim është bërë në kundërshtim me nenin 36 të LPP-së, pasi që nga shikimi i shkresave të lëndës fillimisht vërtetohet fakti se Vendimi i Inspektoratit në bazë të të cilit është bërë propozimi për përmbartim është sjellë në origjinal, ndërsa sa i përket asaj se dokumenti nuk e përmban klauzolën e përmbartueshmërisë dhe ekzekutueshmërisë, as ky përfundim për Gjykatën e Apelit nuk mund të pranohet për faktin se nga dokumenti në bazë të të cilit është kërkuar përmbartimi e përmban njoftimin se se ankesa e parashtruar në këtë vendim nuk e shtyn ekzekutimin.

Neni 24 paragrafi 3 i LPP-së përcakton se: “3. *Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë.*”

Ndërsa neni 144 i LPA-së, paragrafi 1, nënpar.1.4 përcakton se: “*Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.4 njoftimin e palës me aktin e ndalimit të efektit pezullues të ankesës, në pajtim me paragrafin 3 të nenit 386 të këtij Ligji*”, e që organi që e ka nxjerrë vendimin, pra inspektorati i punës e ka njoftuar palën debitore se ankesa kundër këtij vendimin nuk e shtyn ekzekutimin.

Në riprocedurë Gjykata e shkallës së parë duhet të veprojë konform vërejtjeve të kësaj Gjykate ashtu që fillimisht të eliminoj shkeljet e konstatuara, e më pas të vlerësojë edhe njëherë pretendimet e palëve në procedurë si dhe të vlerësojë edhe njëherë lejueshmërinë e përmbarimit e më pas të merr një vendim të drejtë dhe të ligjshëm e të pranueshëm edhe për këtë Gjykatë.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se “*në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual*”.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 209 par 1, pika d) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitivin të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
CAP.nr.919/2023, me datë 30.04.2024

Gjyqtarja  
Hidajete Gashi Alaj, d.v.